

## Te dhenat dhe vellimi i projektit

**Qellimi i aktiviteti:** eshte kryerja e sherbimeve te riparimit dhe te mirembajtjes te motorrave, te automjeteve te tipeve dhe permasave te ndryshme si dhe parkim te tyre, duke perfshire ne kete dhe ushtrimin e aktiviteti te Lyerjes dhe te Lustrimit te makinave l gjitha objekti eshte i rrethuar me mure te rregullt.

Makinerite dhe pajisjet do te jene te thjeshta te gjitha me drejtim manual dhe te sigurta ne perdorim. Autoservisi ne te cilin kryhen te gjitha keto sherbime do te punoje te procese pune pa presion dhe temperatura te larta. Temperaturat me te larta mund te jene ate qe do te krijohen per shkak te saldimit qe do te krijoje procesi i punes ose i prerjes se metaleve ne procesin e riparimit te tyre, e cila eshte krejt e lokalizuar dhe me kapacitet shume te ulet(edhe saldimit neqoftese do duhen te perdoren. Tani per tani nuk jane te vendosura pajisjet e saldimit por ne rast se do te perdoren do te merren masa parandaluese per ndotjen mjedisore.

## Teknologjia

### Kapaciteti dhe regjimi i punes

Mbi bazen e permasave te ambientit te parashikuar per piken e sherbimit te autoservisit per lyerje dhe lustrim makinash ku nje pjese te magazines do zihen nga keto produkte duke krijuar lehtesira per ne kete objekt, te regjimit te punes prej 388 dite ne vit, me nje nderrese me 10 ore, menyres se ambalazhimit te tyre, behen llogaritjet perkatese per teknologjine e mundshme. Keshtu ne perspective eshte e mundshme, per menyren e tregtimit si dhe ndonje perpunim tjeter te diktuar nga ambalazhimi, te nderhyet per ndryshime ne teknologji. Fumizimi i pikes do te behet nga pikat e tregtimit me shumice te vajrave lubrifikant ne vend.

Te gjitha paisjet elektrike jane te llogaritur me nje fuqi te instalimit 2.0KW dhe ne objekt per furnizimin me energji eshte instaluar nje trasformator me fuqi 300kW. Hyrja per ne ambientet e pikes se sherbimit per automjete eshte lindore dhe secili ambient ka hyrje direkte , ose mund te themi qe ambientet funksionojne vec dhe i sherbejne personelit duke mbajtur edhe mjete te domosdoshme si dhe vajra lubrifikante te ambalazuara per sherbimin qe ofrojne. Instalimet e zyrave jane komforme normave e rregullave teknike dhe te MNZSH.

### Zgjedhja e skemes teknologjike

Skema teknologjike e pikes se sherbimit per automjete mund te zgjidhet ne varesi te kerkeses se konsumatorit ku konsumi i solventeve per kryerjen e ketij sherbimi shkon deri ne 0.45 ton/vit. Pra per menyren e zgjidhjes nga ana funksionale te ketij mjedisi duke e pajisur me dy dyer, te jep mundesi per pershtatje teknologjike, referuar pervojës ne vend si dhe asaj te huaj per objekte te ketij karakteri.

Skemat teknologjike te mundeshme te pershtatura mbeshetur ne syzjerimet e mesiperme, nuk sjellin asnje dukuri, qe te shkaktoje ndotjen e mjedisit.

## 1.1.Pjesa e pergjithshme e aktivitetit

Vendndodhja e sheshit te ndertimit

Pozicioni i tij favorizon mundesine funksionale te mjeteve per sjellje dhe hapesira te medha per parkim si dhe ndodhet larg zonave me banim te mesatar apo te dendur.

Plani i pergjithshem dhe kompozimi i objektit

Vendosja dhe kompozimi i pikes se sherbimit per autoservisin per automjete eshte realizuar duke konsideruar teknologjite e mundeshme te pershtatshme per objekte te ketij karakteri. Ne objektin e detyres, vendosja per kete ka qene harmonizimi optimal i aktivitetit me nje sipërfaqe te shfrytëzuar maksimalisht. Mbi keto synime eshte realizuar shtrirja ne plan e objektit, paraqitur kjo edhe ne pjesen grafike perkatese.

Transporti i brendshem

Ne kompozimin ne teresi te objektit eshte patur parasysh edhe mundesia e manipulimit sa me te pershtatshem te mjeteve qe fumizojne si dhe te atyre qe fumizohen per subjekte te ndryshme lidhur .me kerkesat qe kane.

Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit pikes se sherbimit per automjete dhe tregtimi i pjeseve motorrike ne funksion te aktivitetit dhe lysterjes dhe lustrimit te makinave.

Objekti do te jete pike servisi me te gjitha pajisjet dhe celesat e nevojshem te cilat do te merren nga importi dhe furrat e lysterjes qe do te kryejne procesin e lysterjes se makinave. Ate do te jene bashkekohore dhe te lehta ne perdorim dhe manovrim. Ne kete objekt do te kete aneks magazine ku do te fumizohen nevojat per ate pjese kembimi qe duhen zevendesuar, por me e rendesishmja do te kete, qe do te sherbeje per zevendesimin e pjeseve te kembimit per motorat e automjeteve ose autoveturave, te cilat gjate kryerjes se sherbimit ne autoservis kerkojne zevendesimin e menjehershem te tyre me pjese te reja. Per te fituar kohe, automjeti merr menjehere pjesen qe i nevojitet dhe sherbimi kryhet mjaft shpejt. Pra do te kete nje oficine autoservisi qe ka per qellim kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes dhe riparimeve te motorrave te automjeteve te tipeve te ndryshme. Do te punoje ne pjesen me te madhe te kohes me nje turn ose edhe me gjate ne varesi te kerkesave. Ka te punesuar 2 specialiste te fushes, te afte per te kryer disa lloje sherbimesh perfshire dhe prerjet e metaleve nese do te duhen.

Makinerite dhe pajisjet kryesore do te jene:

- Pajisja e ngritjes se automjeteve( urat) me kapacitet 20ton,
- Elektrongritesa te vegjel me fuqi deri ne 10kW,
- Vegla te ndryshme trapano bangoje, gurzmerilo bangoje, impiante per karikim te baterive,
- Pajisje per heqjen e vajit me vakum dhe derdhjen e vajit te motorrit ne fuci 100 dhe 200 litershe,
- Set veglash dore si trapano, gur zmerilo, set celesash te ndryshem,
- Pajisja per zmontimin e shpejte te gomave etj.

Te gjitha do te jene me konstruksione tradicionale, te komandimit manual. Pesha totale e te gjitha makinerive dhe pajisjeve teknologjike te marra se bashku do te jete 5 000-10.000kg.

Te gjitha pajisjet do te vihen ne levizje me ane te energjise elektrike. Fuqia totale e instaluar nuk do ti kaloje 10kW.

Furnizimi me uje do te jete pjese e rendesishme e aktivitetit. Furnizimi do te behet nga linja e ujesjellesit te zones ne rrjetin e rregullt dhe keshtu do te sigurohet uji i rrjedhshem dhe i bollshem per 24 ore. Por uji mund te sigurohet nga rrjeti i ujesjellesit per te cilat mund te themi se ka uje te bollshem deri ne thellesi 20m, nese do te jete i kerkuar ne vitet ne vijim per uje jo per konsum per pirje.

Procesi i prodhimit dhe karakteristikat operative te projektit.

Objekti qe po analizohet per ruajtje te mjedisit do te kete nje teknologji te thjeshte riparimi automjetesh me proces te nderprere. Objekti do te vazhdoje mbi bazen e veprimtarise individuale, pra cdo mjet qe riparohet ose i kryhet sherbimi i plote do te qendroje i fiksuar ne nje vend te caktuar dhe aty i kryhen punimet e nevojshme pa u spostuar.

Me poshte po japim nje pershkrim te shkurter te teknologjise se punes per te evidentuar me hollesi cdo nyje, proceset qe do te ndodhin me qellim qe te krijohet panorama e qarte e parametrave te tij dhe te percaktohen llojet dhe sasite e mbetjeve qe krijohen, si dhe ku emetohen ate ne mjedisin rrethues, shkalla e rrezikshmerise se tyre, si dhe zhurmat, vibracionet, nxehtesia, rrezatimet radioactive eventuale, rrezatimet e forta te drites, e te tjera qe mund te krijohen nga objekti gjate veprimtarise se tij intensive te mundeshme.

Klientet mund te kerkojne per automjetin per t'i bere nje sherbim te vecante si pastrim, nderrim ose shtim vaji, ndonje grasatim te pjeshem, sherbime te pjeseve te vecanta etj. Ne raste te tilla sherbimet kryhen ne moment dhe automjetet do te largohen menjehere.

Ne rastet kur automjetet kane nevojte per sherbime me te thella qe duan me shume kohe, atehere ate ne fillim pozicionohen per pak kohe ne sheshin prites para godines se servisit, ku degjohen predendimet dhe kerkesat e pronarit te automjetit per sherbime qe kerkon ti behen dhe pastaj behet inspektimi nga specialisti i pikes se servisit per identifikimin e plote te punimeve qe do te kryhen.

Punimet mund te jene te castit, qe kryhen ne prani te vete pronarit te automjetit, ose te zgjatura, te cilat kerkojne qe automjeti te qendroje per nje kohe ne piken e servisit.

Ne vijim jepet nje pershkrim dhe analize me hollesishme e procesit te punes per cdo hallke te tij duke vene theksin ne menyre te vecante ne lendet mbetese qe prodhohen, lloji, perberja, sasia, nyjet ku shkarkohen ne mjedis, si dhe shkalla e rrezikshmerise qe ate paraqesin atje ku shkarkohen ashtu edhe me tej.

Llojet e punimeve qe do te kryhen ne autoservis:

Punimi kryesor eshte riparimi i pjeseve xhenerike dhe pjeserisht i motorave te autoveturave, por ne te ardhmen mund te shtohen:

- -Pastrim
- -Riparime xhenerike
- -Riparim tapicerie
- -Riparim e fryrje gomash
- -Ndrrim vaj e grasatime te mundeshme
- -Riparime te sistemit elektrik perfshire edhe karikimin e baterive

- -Riparime te sistemit te ngrohjes
- -Zevendesime te motorrinove, dinamove, pompave te ujit, pompave te vajit, etj.

Per te realizuar punimet dhe veprimet e mesiperme nevojiten

Gjate procesit te punes ne servis do te kete keto procese kryesore:

-Pastrim me uje dhe pjeserisht me detergjente.

-Saldime dhe prerje metalesh me aparate oksid-acitilene dhe saldatrice elektrike me dhe pa gaz inert

-Punime metalesh ne gur zmerilo dhe cpime ne trapano.

-Nxehje detalesh te ndryshme te bokullave dhe kuzhinetave per nxjerrjen dhe futjen e tyre ne vendin perkates.

-Goditje te ndryshme metal me metal me cekic dhe varre per drejtime te pjeseve te deformuara apo per akjopim-cakopjim pjesesh te ciftezuara.

-Mberthime ose zberthime te gomave me dore ose mjete te mekanizuara.

-Punime te ndryshme ose zberthime pjesesh qe kerkojne te zevendesohen.

Per larje do te perdoret uji ose detergjente te ndryshem. Uji do te merret nga linja e ujesjellisit te qytetit. Ujrat pas larjes permbajne baltra e papasterti, gjurme hidrokarburesh, gjurma ndryshku dhe ndonje papasterti tjeter qe mund te ndodhet ne siperfage. Uji gjithashtu, permban sasira te vogla detergjenti me te cilat ferkohen siperfage te vecanta te pjeseve te nderrimit, qe shplahen me pas me uje.

Gjate procesit te prerjes dhe saldimit te pjeseve metalike te motorrave ose automjetit me vegla oksidacitilene mund te perdoret gaz acitilen dhe oksigjen, mepermjet djegjes te te cileve arrihet temperatura e nevojshme per shkrirjen e metaleve dhe me tej per sadimin, prerjen apo nxehjen e tyre per zbutje per qellime rregullimi.

Gjate djegjes se acitilenit ne prani te oksigjenit me pasterti deri ne 98%(rreth 2%azot) clirohen gaze me permbajtje kryesisht bioksid karboni, avuj uji, okside metalesh si dhe gjurme shume te vogla te monoksidit te karbonit. Kete gaze, te cilat kane temperature te larte ikin menjehere ne atmosfere, direkt nga vendi ku realizohen punimet. Per kete qellim eshte e domozdoshme qe objekti te pajiset ne te ardhmen me aspiratore, ne rast se do te futet edhe ky lloj sherbimi, ne zbatim te funksionimit teknik normal.

Ne procesin e punimeve mberthim- zberthim, ne ate te prerjes me oksiacitilen apo me elektrik, krijohen rrezatime te fuqishme drite shume te demshme per syrin e njeriut. Personeli perkates do te jete i mbrojtur me ane te maskave speciale. Per mbrojtjen e njerezve te tjere ne kete raste perdoren perde metalike portative me te cilat rrethohet vendi ku saldohet.

Ne gur zmerilo do te krijohen pluhura me permbajtje nga materiali i gurit dhe nga metali nga i cili eshte bere detali qe punohet. Ate duhet te thithen me aspirator te pershtatshem me qellim qe te mos lejohet dalja e tyre ne mjedisin e punes dhe me tej. Mbas thithjes ate mbahen ne filtrin perkates, mbas te cilit ajri i pastruar shkarkohet ne atmosfere.

Ne trapano krijohen ashkla metalike te shperndahen mbi bangon e saj. Gjithashtu do te shperndahet edhe uje qe perdoret per ftohjen e puntos se shpimit. Uji eshte pa permbajtje te demshme te vecanta dhe shkarkohet ne sistemin e kanalizimit te brendshem dhe nepermjet tyre ne kolektorin e ujrave te shumte.

Gjate goditjeve per futjen dhe nxjerrjen e detaleve te ciftezuara, gjate zberthim-mberthimit te rotave me pajisje dore pneumatike apo elektrike si dhe gjate fryrjes se gomave me ajer nga

kompresori qe do te instalohet ne piken e servisit (ne rast se do te zhvillohet ky lloj aktiviteti), krijohen zhurma te niveleve te ndryshme, te cilat jane shume periodike dhe per nje kohe te shkurter dhe te pademshme per mjedisin rrethues.

Heqja e vajit nga automjetet do te behet duke thither me pajisje me vakum, duke mos lena asnje mundesi qe vaji te derdhet ne mjedis.

Gjate procesit te realizimit te baterive akumulatore do te krijohen avuj acidesh dhe hidrogjen, te cilat do te thithen me aspirator te pershtatshem dhe nepermjet oxhakut me lartesi te mjaftueshme hidhen ne atmosfere. Per pastrime te detaleve te ndryshme, ne raste te vecanta perdoret vajguri ose nafte motorrash dhe lecka pambuku, te cilat pas nje ose disa perdorimesh, sipas rastit do te hidhen ne vendgrumbullimin e mbetjeve te ngurta te caktura nga Bashkia Shijak.

Per mbrojtjen e mjedisit do te behet qe ne objekt ndarja e mbetjeve sipas rrymave:

- Mbetje organike
- Mbetje te biodegradueshme (hotelerike)
- Mbeturinat plastike.
- Mbetje leter apo karton.
- Mbetje te legeta te hidrokarbureve.

### ***Lendet e para***

Aktiviteti i pikes se servisi nuk perpunon lende te pare ne kuptimin e mirefillte te fjales, por ai ve ne pune pjese te gatshme si detale te ndryshme metalike, plastike, prej gome, tekstili, druri dhe vajra te ndryshme lubrifikante si dhe lendet e para qe perdor per lysterjen dhe lustrimin e makinave.

Lendet ndihmese

Kete jane energjia elektrike, uji e gjithcka tjeter ne sherbim te punes qe nevojitet per pastrimin dhe mirembajtjen, riparimin, kontrollin sherbimin apo materiale te tjera. Instalimet hidrike do te vendosen ne menyre konkrete ne sherbim te pozicionit te duhur dhe me sa me pak rruge te ndotjes ne permbajtje mbar perdorimit. Materialet ndihmese te tjera te permendura me siper sigurohen ne rruge tregtare te leverdiseshme. Uji do te merret nga linja e ujesjellesit.

Acetileni sigurohet si gaz i gatshem ne bombola dhe jo si karbit kalciumi i ngurte. Kjo per te evituar mbetjet e ngurta dhe te lengeta qe lindin nga prodhimi i gazit prej tij.

Mjedisi eshte gjithmon i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejt/te terthorte/te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky projekt ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne faza e operimit pasi objekti eshte i ndertuar. Nuk marrin ne konsiderat fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te sherbej si nje pike sherbimi per automjete.

Efektet e mundshme nga projekti qe do te implementohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshem nga ky raporti kesaj gjendjeje ne mjedis. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

#### MASAT LEHTESUESE

Arkeologjia dhe trashegimia kulturore

Per shkak te distances shume te larget ndermjet studimit te propozuar dhe zonave me trashegimi kulturore, masat lehtesuese nuk jane kerkuar e nuk jane propozuar.

Terreni dhe sherbimet per terrene pamore: Trajtimet e terrenit do te sigurojne qe bimesia vendase eshte shfrytezuar per llojet e propozuara. Do te merren masa te vecanta lehtesuese per zonen perreth. Te tilla masa pershijne ndertimin me bimesi te pengesave kundrejt zhurmes dhe nderhyrjes pamore per shkak te projektit.

Shkarkimi, gjeologjia dhe dherat: Grumbullimet e dherave/inerteve kudo qe do zhvendosen duhet te menaxhohen saktesisht dhe te depozitohen para se te riperdoren. Kjo duhet te jete praktike qe te perdoret menjehere dhe nese jo duhet te depozitohet ne lartesira prej jo me shume se 2m ,dhe pervec kesaj nuk duhet te grumbullohet ne vend grumbullime jo me shume se 1 vit.

Grumbullimet e dherave/inerteve nuk duhet qe te transportohen para se te behet sistemimi apo kur jane ne grumbullimet e dherave/inerteve nuk duhet te mbingarkohen apo te shkarkohen menjehere dhe duhet te kene nje minimum per menaxhimin e shumefishte. Per me tej masa me materiele inerte nuk duhet te germohet nga depozitimet, si ne kantier apo te importuara te cilat ekspozohen nga grumbullimi i rreshjeve qe e kalojne 100mm ne 28 ditet e ardhshme. Keto detaje duhet te nenvizohen ne Kontraten e Punimeve.

Megjithate, do te behet e paevitueshme nje perpjestim te materialeve inerte, per arsye te zoterimit fizik dhe strukturor te tyre, te cilat nuk jane te pershtatshme per mbushjen inxhinierike. Ky material eshte i pershtatshem per veprimtarite e tjera te ndertimit sic eshte terreni ku nuk duhet aplikuar fare nje deformim i tille strukturor. Riperdorimi i ketij materiali do te maksimizohet brenda konturit te projektit dhe duhet te merret material shtese, kjo do te transportohet jashte kantierit dhe te vendoset ne nje pozicion duke rene dakort me autoritetin vendas. Me qellim qe te parandalohet demtimi i materialeve per rishfrytezim do te menaxhohen dhe transportohen deri ne nje minimum dhe te depozitohen ne nje menyre te tille qe te minimizohen efektet e motit mbi to.

Gjate periudhave te zgjatura me thatesire, kontraktori do te pezulloje punimet dhe vendosjen e ketyre materialeve, per te parandaluar degradimin. Kjo do te ule sasine qe duhet te hiqet nga kantieri.

Ne perfundimin per punimet do te ndermerren inspektive vizuale ne te gjitha strukturat gjate gjithe kohes se punimeve, per te siguruar qe keto shtresa nuk shkaktojne erozion, si dhe te identifikojne kerkesat e duhura, ato qe duhen per te ndermarre cdo pune te menjehershme.

Kjo mund të minimizojë impaktet e ardhshme të mundshme të humbjes së dherave apo inerteve dhe impakteve të lidhën me terrenin si shkak i erozionit edhe pse ndikimi është minimal.

Hidrologjia, ujrat sipërfaqesore dhe nentokesore: Shkarkimi i mundshëm i materialeve në ujë mund të konsiderohet një impakt negativ. Megjithatë raporti i VNM-së i kërkon paletë së Kontraktorit që të zbatojë procedurë të qëndrueshme për të ulur rrezikun e ndotjes së rrjedhave të ujrave, sado i vogël qoftë impakti. Megjithatë, cilesia e ujrave nentokesore duhet të ruhet rreth 50m larg rrjedhës së burimit dhe për këtë impakti është i padallueshëm.

Gjate këtyre proceseve do të merren edhe masat për kontrollin e ndotjes. Këto do përfshijnë kushtin për ndertimin e rrethimeve. Grumbullimet për materialet e ndertimit siç është asfalti, vajrat/hidrokarbure, materiale të tjera ndertimore inerte nuk duhet të zhvendosen afër ndonjë sipërfaqeje ujore. Këto grumbullime do të vendosen në sipërfaqe të izoluara, të mbuluara me ndonjë lloj mbulese të përhershme dhe të rrethohen nga një rrethim që të parandalohet rrjedhja e derdhjeve. Grumbullimet duhet të mbrohen nga vandalizmat e rastësishme dhe vjedhjet që mund të çojnë në derdhje të tyre, etj.

Derdhja e ujrave të grumbullara që shkarkohen nga kantieri i punimeve do të trajtohet në përputhje me llojin e tyre si dhe do të derdhen në një mjedis prites me të njëjta parametra. Uji që vjen nga larja e gomave dhe nga pajisjet do të trajtohet me sedimentimin në një rezervuar të montuar pranë kantierit të ndertimit, për materialet e shtresave dhe interceptoret e vajit që mundesojnë materialet e imta dhe vajrat që duhet të eliminohen me pas. Uji që vjen nga larja e agregateve dhe nga prodhimi i konglomerateve që do të trajtohen nga sedimentimi i rezervuareve dhe me pas të shfrytëzohen serish pjesa e përdorshme ndërsa pjesa që nuk do të nevojitet për punime në kantier do të shkarkohet në një mjedis tjetër ujor por jo pjesa ku ka mbetje të ngurta apo të demshme. Atje ku do të derdhen ujerat, do të kontrollohet niveli i ujrave prites që të mos shkarkohet permbytje të lokalizuara në këte mjedis ujore. Në rastin e një derdhje serioze të lendeve si karburante të lengeta apo lengjeve gjatë ndertimit, do të përcaktohet nga ana e Kontraktorit një program për matjet e ujrave sipërfaqesore dhe nentokesore si dhe do të grumbullohen në një rezervuar ndares lëngu dhe vaji (një problem i tillë nuk do të shfaqet gjatë realizimit të këtij projekti). Gjithashtu pranë çdo depozite për mbajtjen e lendeve fosile për makinerite apo për mjetet do të vendndosen në një mjedis të betonuar ku pranë çdo rubineti do të vendoset një pjatë prej alumini për të shmangur çdo pikim të mundshëm aksidental ku me pas do të riperdoret.

Testimi i ujrave nentokesore duhet të bëjë matje në terren të pH, turbulencën dhe nxitjen elektrike. Testet e ujrave nentokesore që janë marre duhet të jenë në sasi të mjaftueshme për të lejuar analizat për kationat dhe anionet, NBO, NKO5, metalet e rënda, vajrat dhe lubrikantet. Provat duhet të merren nga një person shumë i aftë teknikisht dhe të analizohen në një laborator të akredituar.

Për periudhën kur rrugecat e brendshme në këte kantier janë në ndertim e sipër, duhet të merren masa lehtësuese për kohë që do të zgjasin punimet të cilat duhet të projektohen në skemë para se të nisë kontrolli i ndotjes dhe parandalimi i rrezikut nëse hasen probleme.

Habitati dhe biodiversiteti: Humbja e tokës, të siperfaqeve me vegetacion për shkak të implementimit të këtij projekti është i përvetësues por impakti i këtij projekti është i vogël. Kjo vjen si rezultat se kjo zonë nuk është e pasur me bimësi si dhe madhësia e këtij projekti është relativisht e vogël. Humbja e habitatëve me vlerë nuk konsiderohet si një problem i cili nuk do të haset gjatë fazës së operimit meqë toka përreth nuk është e gjelbëruar dhe as e mbjellë me pemë apo e shfrytëzuar si tokë bujqësore. Kampi i punimeve dhe rrethina duhet të instalohet në një shesh të zhveshur nga bimësi. Kontrata do të parashtrijë të gjitha fazat që do të ndiqen që të shmangim ndikimin tek habitatet, gjithashtu duhet të programohet që të sigurojë mos shqetësimin e zogjve shtegtarë të kësaj zone edhe pse janë në nivele të paperfishme. Për zogjtë shtegtarë në zonën nuk krijon asnjë problem apo shqetësim pasi prona nuk është e pasur me bimësi dhe me mjedise ujore.

Cilesia e ajrit.: Nivelet e trafikut nga ky projekt do të jenë të ulëta si i tillë ato shkaktojnë shkarkimet tepër të pakta duke marrë në konsideratë gjithashtu përmirësimin e shkarkimeve për automjetet e reja si edhe për automjetet e vjetra që janë zëvendësuar. Një procedurë për modelimin e tyre është përfshirë në mënyrë që të bëhet parashikimi për nivelet e shkarkimit të emisioneve si dyoksid azoti (NO<sub>2</sub>) dhe pluhur LGS si dhe i rëndësueshëm (PM<sub>10</sub>) që prodhohen nga punimet.

Megjithatë, me qëllim që të verifikohet cilesia e ajrit në zonën e studiuar, duhet të ndërmerren prova para se të nisë ndërtimi i projektit dhe pas disa muajsh të përdoret testimi pasiv si pjesë e kontrollit ambjental. Gjatë këtyre fazave, zbatimi i sistemeve për ngjeshjen e pluhurit sic është lagësia me ujë dhe sheshit të kësaj dhe e rrugëve hyrëse dhe dalje nga kësaj, të cilat do të ndërmerren nga investitori do të limitohen deri diku shkarkimet e pluhurit në ajër. Do të përfshihen të gjitha standartet e emetimit në ajër që udhëzojnë direktivat e BE-së dhe legjislativi i Shqipërisë për normat e shkarkimeve në ajër. Gjithashtu gjeneratori do të pajiset me marmite për të ulur efektin e ndotjes së ajrit nga djegia e lëndëve djegëse si dhe të zhurmave.

Zhurmat: Masat e mëposhtme janë tepër të rëndësishme që duhen aplikuar nga investitori gjatë tërësisë së punimeve për këtë projekt:

- Asnjë impiant në kësaj të shfrytëzuar për punë të caktuara nuk do të lejohet që të shkaktojë zhurmë mbi nivelin e lejuar në mjedise përreth zonës
- Me e mira mundshme nga ana praktike, bëhet duke përfshirë një impiant të përfshirë për mirëmbajtje, i cili do të shfrytëzohet për të minimizuar zhurmën që vjen nga ndërhyrjet në terren.
- Të gjitha automjetet dhe makineritë mekanike do të përfshihen mirë me të gjithë silenciatorët e mundshëm dhe të mirëmbajtur në gjendje të mirë pune gjatë gjithë zgjatjes së punimeve.
- Kompresoret duhet të përfshihen sipas modeleve përkatëse me kapakët e radhitur dhe të mbyllur mirë të cilat do të mbahen mbyllur për sa kohë që makineritë janë në punë dhe të gjitha mjetet e tjera shtesë pneumatike që do të përfshihen me silenciatorët përkatës.



- Makineria qe do te perdoren do te mbyllet here pas here ne kohen kur nuk do te nevojitet per shfrytezim.

- Cdo lloj instalimi, sic jane gjeneroret apo pompat/motoret qe jane te nevojshme per nderhyrje dhe pas oreve te ligjshme te punes do te mbeshtillen me nje pjese akustike apo ekran te levizshem per te minimizuar ndotjen akustike te mjedisit perreth.

Komuniteti lokal dhe aspektet social-ekonomike: Gjate punimeve do te merren masa te vecanta nga ana e investitorit, me qellim qe te behet mirembajtja e ujit, elektricitetit apo te ndonje rrjeti tjere ekzistues ne kete prone, ku te gjitha punimet do te kryhen pasi te jene informuar institucionet pergjegjese ne numrat e tyre te telefonit. Kanali e vaditjes apo i drenazhimit do te mirembahen per nje funksionim te rregullte gjate punimeve ne kete zone.

Nuk do te kete zoterim apo shpronosim pasi prona i perket vete investitorit i cili eshte dhe pronari i prones ku eshte zhvilluar projekti. Ne kete zone niveli i popullsisë urbane eshte i ulet dhe ne keto zona ka zhvillim mesatar te zonave me destinacion komercial. Prona eshte blere tek pronaret e ligjshem dhe eshte prone private dhe eshte ne proces legalizimi.

Masa lehtesuese te tjera te kerkuara

Do te behet nje menaxhim sa me me eficient te energjise elektrike. Impiantet e nevojshme jane projektuar ne perputhje me Ligjin e ri, nr.9379, date 28-04-2005 "Per Eficencen Energjise", kjo do te coj ne uljen e ndotjeve termike te mikroklimes se zones si dhe kursim te energjise elektrike nga perdorimi i makinerive me eficence.

Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese.

Do te instalohet sistem i ujitjes per mjedisin perreth(varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato do te kene) si dhe lagja me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor, si dhe krijimi i kanaleve te kullimit ne kantier ku ujerat e tyre do te derdhen ne mjedin ujqor te kanalit aty prane prones por jo te ndotur me hidrokarbure.

Do te behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat do te jene; lende te aballazheve, letra-kartona, qelqe, alumine si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit ku keto mbetje do te depozitohen ne vendin e caktuar nga Bashkia , ku firma do te marre masa per menaxhimin e ketyre mbetjeve te ngurta, do te vendosen ne kosha selektive(nese do te filloj zbatimi i projektit te menaxhimit te mbetjeve) ku me pas do te transportohen nga automjetet e pastrimit te qytetit per ne vendet e caktuara prej tyre. Mbetjet e ngurta urbane te prodhuara, do te depozitohen ne kosha te percaktuar nga Bashkia Shijak ku do te jete nje sasi prej 0.4kg/dite per person. Per kete projekt do te ndertohet xhepi i kontenjerit sipas kushteve te caktura nga Drejtoria e Pastrimit te Territorit.

Do te ndertohet kanali i drenazhimit te ujit te shiut ne kete kantier ose e mjedisit perreth drejt mjediseve te gjeberuara, nje mundesi e mire dhe per vaditje dhe shmangie te derdhjes se tyre ne mjedis si dhe shmangie te perdorimit te ujit te pijshem per vaditje.

Mjedis i gjelberuar perreth do te jete nen kujdesjen e personelit qe do te punesohet vetem per punimet agro-mjedisore te nevojshme.

Do te tokezohet rrjeti elektrike per te shmangur ndonje shkarkese elektrike, konform kushteve teknike,

Do te merren keto masa kryesore te mbrojtjes kundra zjarrit. Do te perdoret uji i marre nga rrjeti i shperndarjes se ujit apo nga rezervuaret qe do te vendosen ne sheshin perreth per rastet e emergjences(zjarret e mundshme qe mund te bien). Rrjeti per shuarjen e zjarreve duhet te jete i lidhur me rrjetin e ujit perkates per nevojat e ketij projekti. Ndertimi i ujesjellesit te pavarur per fikjen e zjarrit lejohet vetem ne rastet kur nuk eshte e leverdiseshme qe aty te lidhet me ujesjellesin e ujit. Ne kete projekte harxhimi i ujit per shuarjen nga jashte te zjarreve duhet te merret 20 l/sek. Ujesjellesi per shuarjen nga zjarri duhet te ndertoht me presion te larte dhe te ulet. Hidratet zjarrefikese te vendosen 1.25 m nga niveli i dyshemese ku kapaciteti i tyre mbajtes do te jete 70L per cdo hidrant te montuar ne keto mjedise. Per te mbrojtur kunder zjarrit te mundshem qe mund te bjere do te ruhen largesite mbrojtese ndaj zjarrit ndermjet sheshit dhe objektit perreth si dhe ndermjete objektit qe ndodhet ne sheshin ne studim. Do te lihen distancat e percaktuara per rruge kalim te automjeteve, zjarrefiksive.

Per te shmangur ndotjen e ujerave nentokesore nga Ujerave te Ndotura Urbane te kesaj zone do te lidhet me rrjetin e kanalizimeve te kesaj zone, rrjeti do te projektohet konform kushteve teknike si dhe ne zbatim te legjislacionit ne fuqi. Ndersa ne lidhje ne burimet e furnizimit me uje, do te jene te mjaftueshme per te permbushur kerkesat gjate nje viti, veçanerisht gjate muajve te veres, kur normalisht kerkesa eshte me e larte. Furnizimi me uje do t'ju sigurohet ne nje nivel te tille presioni, ne menyre qe te jete i mjaftueshem per te shperndare sasine e nevojshme te ujit edhe per katet e tjera te objektit, por jo aq sa te demtoje pajisjet hidraulike(efekti i grushtit hidraulik) ose te krijoje rreziqe tek konsumatori(punonjesit). Gjithashtu rrjeti hidraulik te furnizimit me uje per objektin do te sigurohet uje i pjshem i sigurt, bazuar ne Standardet Shqiptare, ne çdo kohe perdoruesve brenda sherbimit te zones se caktuar. Uji do te jete bakteriologjikisht dhe kimikisht i sigurt per perdorim sipas nevojave te caktuara ne perputhje me standardet shqiptare.

#### Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune

Zbatimi i ketij projekti nuk do te sjelle rrezikshmeri per aksidente, duke qene se nuk do te kete mbajtje ose perdorim i substancave te rrezikshme. Ne rast se do te kemi derdhje te lendeve si hidrokarbure nga automjetet e transportit do te merren masa per largimin e saj nga mjedisi si dhe do te vendosen tabela sinjalizuese per te shmangur aksidente rrugore gjate hyrjes dhe gjate daljes si nga kantieri.

Ne kete sheshe do te jene objekte te ndertuar me planimetri te rregullt duke respektuar kriteret teknike per funksionimin normal te tij. Ai ka siperfaqe te mjaftueshme per kryerjen e proceseve te levizjes se mjeteve, shkarkimeve te materialeve, magazinimit ne sheshet perkatese dhe hapësira te medha per kryerjen e aktiviteteve te tjera , dhomat higjeno-sanitare, dhomat e zhveshjes,etj.

Rrjeti elektrik i zones do te jete i ri, gjate zbatimit te projektit per kete rrjet eshte pasur parasysh qe te realizohet togezimet e nevojshme per te gjitha makinerit, dhe pajisjet e nevojshme. Punonjesit do te sensibilizohen dhe do te detyrohen te respektojne me perpikemeri te gjitha rregullat per sigurimin teknik.

Detyrimet e punedhënesit: Punedhënesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1. Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne frontin ku punon.
2. Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne kantier.
3. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
4. Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
5. Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.
6. Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne kantierin e punes, per tu mbrojtur nga makinerite, rrymes elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.
7. Ndhimen e pare shendetesore.
8. T'u krijoj punonjesve te mira pune dhe jetese, si: mjete mbrojtese, ushqim falas dhe fjetje kur punimet kryhen larg vendbanimit te punonjesve.
9. Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.
10. Frontet e punes ne zbatimin e objektit, po te punohet naten duhet te ndriçohen me projektore qe furnizohen nga rrjeti elektrik ne menyre te pa varur nga ndriçimi individual i mjeteve motorike. Kur mungon ndriçimi ndalohet puna.
11. Ndalohet qendrimi dhe kalimi i punonjesve brenda rrezes se veprimit te mjeteve ngarkuese dhe transportuese, kur ato jane duke punuar.
12. Ndalohet riparimi i avarive, grasatimi dhe punime te tjera kur makinerite jane ne levizje.
13. Çdo turn para se te fillohet nga puna behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e makinerive etj.
14. Gjithashtu duhet tu njohe rregulloren e mbrojtjes kundra zjarrit si dhe trajnimi i punonjesve ne ketij objekti duke krijuar situata te simuluara.

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve ne zbatimin e projektit, per çdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4. Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithë punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik.
5. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, rrobat me çizme pune, doreza, maskat e mbrojtjes nga pluhuri dhe tapa veshi per zhurmat, uniforme te vecanta si dhe veshje kundra zjarrit, etj.
6. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

#### PLANI I MONITORIMEVE MJEDISORE

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e investitorit per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te ligjit "Per monitorimit e mjedisit ne Republiken e Shqiperise", kreu III, pika 10

Plani i monitorimit mjedisor eshte i inkorporuar ne projekt dhe perfshin inspektime dhe raportime rutine. Me poshte do te paraqesim disa monitorime qe do te realizohen per treguesit e trysnise ne mjedis qe jane detyre e investitorit ku ai do te bashkepunoj me instancat perkatese.

Monitorimi i tokes dhe i erozionit: Minimizimi i erozionit, gjithashtu duhet te jeta nje detyre primare gjate pergatitjes se sheshit te ndertimit. Monitorimi i te gjitha dokumentacionit te projektit te miratuar, etj eshte objekt i kontrollit te vazhdueshem te shoqerise zbatuese.

Gjate fazes se punimeve ne terren do te inspektohen te gjitha punimet javore nga ekspertet perkates per tu siguruar qe masat per erozionin e tokes jane siguruar sic duhet.

Ne raste se konstatohet qe masat nuk jane zbatuar ashtu sic duhet atehere eksperti do te njoftoje menjehere kontraktuesin dhe supervizorin i cili do te jete i pergjegjshem qe te merren masat e duhura dhe korrekte.

Monitorimi i cilesise se ujit: Monitorimi para fillimit te operimit per te vendosur kushtet fillestare, duhet bere ne zonat qe ka vendosur supervizori. Monitorimi fillestar i cilesise se ujit rekomandohet ne zonat me burimet me te medha te ndotjes potenciale te ujit (kampet e ndertimit dhe te burimeve te tjera te rrjedhjeve te rendesishme dhe prodhimit te ndotesve te lenget.

Rekomandohet matja e grimcave ne suspence (MES), kerkesa biologjike per oksigjen DBO5, konduktiviteti dhe coliformet fekale dhe niveli i vajrave e grasove. Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet nga inspektoret e mjedisit(supervizori) gjate punimeve.

Monitorimi i cilesise se ajrit: Monitorimi para ndertimit/montimit per te vendosur kushtet fillestare, duhet bere ne zonat qe ka vendosur supervizori, perbrenda zones qe do te ushtrohet ndikimi.

Monitorimi me aparate per ndotesit e ajerit,pervec grimcave totale ne suspence nuk konsiderohet e justifikueshme ne kushtet ekzistuese te ambientit, sepse nuk ka impakte te rendesishme ne kete projekt.

Masat e sigurise per monitorim shtese me kerkese te supervizorit do te specifikohen nese hasen rrethane te paparashikuara.

Monitorimi i zhurmave: Openimi i pajisjeve dhe i makinerive gjate gjithë procesit, kerkon te monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet te kaloje nivelet e caktuara. Ndotja akustike ne mjediset e punes eshte paresore per shoqerine, sepse sjell uljen e produktivitet te punonjesve dhe rritje te stresit.

Investitori do te realizoj monitorim me aparatura, nje here perpara fillimit te punimeve, per te vendosur drejtimet kryesore te impakteve qe do te maten. Monitorimi fillestar i zhurmave do te kerkohet vetem aty ku kohezgjatja e potencialeve te ndikimeve dhe receptoreve e ndjeshem te justifikoj kete monitorim.

Monitorimi i mbetjeve te ngurta: Monitorimit gjata ndertimit, lidhur me pastrimin dhe pergatitjen e sheshit, ka si synim qe te evitohet prerja e drureve gjate pergatitjes se sheshit te ndertimit.

Hedhja e materialeve te nxjerra nga pregatitja e sheshit te ndertimit kerkon mbajtjen e shenimeve perkatese ne regjistrimin e punimeve te kryera. Per kete qellim duhet te behet dokumentimi i materialeve te ngurta te parrezikshme qe hidhen ne vendet e paracaktuara:

Dergimi i materialeve te ndertimit dhe i pajisjeve ne shesh ben te nevojshem inspektimin e perhershem, i cili duhet te realizohet ne lidhje me kontrollin e emetimeve te pluhurit ne atmosfere gjate transportit te dheut apo inerteve.

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndotjet e mundshme qe do t'i shkaktohen mjedisit nga punimet ne kete projekt. Investitori do te monitoroje vetem pikat per te cilat ai ndikon mbi to(pikat do te percaktohen nga organet kompetente), si dhe i dergojne keto te dhena ne Agjensine Kombetare e Mjedisit. Keto te dhena do te vihen ne dispozicion te inspektoreve te mjedisit gjate inspektimit te tyre.

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithë treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit te krijuar gjate aktivitetit, do te çojë perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te parashikuar ne projekt me siperfaqe te sistemuar dhe te gjelberuar.